



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Ministria e Arsimit dhe Shkencës-Departamenti i Arsimit Profesional në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011 Udhëzimin Administrativ 136/2020, për krijimin e strukturës stimuluese për mbështetjen e shkollimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe për vajzat/gratë në Drejtimet teknike në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), si dhe Vendimit Nr. 01- 2688, të datës: 18.06.2026, shpall:

KONKURS

Për ndarjen e njëqind (100) bursave për nxënësit e regjistruar në klasën e 10-të në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) për vitin shkollor 2026-2027

Ndarja e bursave për nxënësit e IAAP-ve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) bëhet me qëllim të mbështetjes së nxënësve në profile deficitare për tregun e punës si dhe në drejtimet teknike për vajza.

MASH ndanë shtatëdhjetë (70) bursa për drejtimet deficitare dhe tridhjetë (30) për drejtimet teknike për vajza. Vlera e bursës është 50 euro në muaj, përkatësisht 500 euro për një vit shkollor. Nxënësit përfitojnë bursë për tri vite të shkollimit sipas kriterëve të përcaktuara me UA 136-2020.

Të drejtë aplikimi për bursë në drejtimet deficitare kanë:

Të gjithë nxënësit të cilët regjistrohen në IAAP, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet deficitare, në këto profile:

- Teknik i sistemeve solare fotovoltaike
- Pylltari
- Agrobiznes
- Asistent i turizmit dhe udhëtimeve
- Përpunim druri/Zdrukhëtar
- Metalpunues

Të drejtë aplikimi për bursë në drejtimet teknike për vajza kanë:

Të gjitha vajzat të cilat regjistrohen në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale (IAAP), të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkurs, kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet teknike, në këto profile:

- Instaluese elektrik
- Instaluese e ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit
- Automekanike
- Teknike e efikasitetit të energjisë në ndërtesa
- Teknike e dizajnit grafik

Kushtet dhe kriteret për aplikim:

- 1.1.** Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2.** Suksesi i shkollimit paraprak – klasat 6-9 (60%);
- 1.3.** Rezultatet e testit të arritshmërisë (40%).

Dokumentacioni që kërkohet për aplikim:

- Kërkesa për bursë (nënshkruar nga nxënësi dhe vulosur IAAP);
- Dëftesën e shkollës së mesme të ulët (kopje);
- Certifikatën e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit të prindit ose kujdestarit ligjor;
- Vërtetimin e llogarisë bankare aktive të prindit ose kujdestarit ligjor, në njërin nga Bankat e Republikës të Kosovës.

Procedurat e aplikimit

- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit nga nxënësit bëhet në IAAP.
- Drejtorët e IAAP-ve i dorëzojnë aplikacionet përmes arkivit në MASH/DAAP deri më **05.10.2026**.
- Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Konkursi do të jetë i hapur nga **09.07.2026** deri më **01.10.2026**.

E drejta e ankesës: Nxënësit që kanë aplikuar por nuk kanë përfituar, kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së rezultateve nga MASH. Ankesat shqyrtohen nga organi epror në MASH.

VËREJTJE:

Kandidatet janë të obliguar që plotësimin e aplikacionit ta bëjnë në mënyrë të saktë dhe të plotë me dokumentacionin e kërkuar, në të kundërtën përgjegjësi bie mbi ta. MASH, rezervon të drejtën të bëjë verifikimin e të dhënave dhe eliminimin e aplikimeve të dyfishta. Në përputhje me këtë

dokumentacioni duhet të jetë i lëshuar nga organet kompetente. Paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, deklarimeve të rrejshme apo dokumenteve që nuk janë të lëshuara nga institucionet zyrtare, përbën veprë penale, e dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe mund të rezultojë me refuzimin e menjëhershëm të aplikimit si dhe ndjekje penale (Ligji për procedurë administrative: Ligji nr. 05/L-031- neni 13 Parimi i vërtetësisë- Palët janë të obliguara të japin informata të sakta dhe të mos paraqesin fakte të rreme).